

KUD 657

**RËNDËSIA E STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË  
KONTABILITETIT DHE REVIZIONIT FINANCIAR NË  
MENAXHIMIN FINANCIAR NË BIZNES**

*Fatos Ukaj*  
*fatos\_ukaj@yahoo.com*  
*Fetije Ukaj*  
*fetijeu@yahoo.com*

**Abstrakt**

Ekonomia e Kosovës e ndërtoj një sistem financiar të pavarur që nga viti 1999 e këtej duke mundësuar funksionimin e ekonomisë që nga ndërmarrjet, sistemi bankar dhe Banka Qendrore si mbikëqyrës dhe menaxhuese e sektorit të financave. Në këtë punim do të pasqyrojmë rolin e menaxhimit financiar dhe implementimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar. Do të shtjellojmë zhvillimin dhe nivelin e arritur të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë. Do të shtjellojmë rendësin e implementimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit Financiar por edhe pritjet dhe përfitimet e atyre që janë të interesuar të përdorin të dhënat, e ata mund të jene edhe investitorët e jashtëm, por edhe opinionin publik dhe mediat që janë të interesuar për zhvillimet në ekonomi dhe institucione. Në punim shfrytëzohen të dhënat e mbledhura nga burime të shkruara por edhe intervista me profesionist dhe menaxher të financave. Në fund do jepen përfundimet dhe rekomandimet për çështjen e shtruar.

**Fjalët kyçe:** Menaxhimi Financiar, Kontabilitetit, Auditimi, Raportimi financiar.

**Abstract**

The economy of Kosovo has built an independent financial system from 1999 onwards, enabling operation of the national economy including enterprises, commercial banking system and Central Bank as supervision and management institution of the finance sector. In this paper we will reflect the role of financial management and implementation of international reporting standards. We will examine the development and achievements on implementing of accounting and audit practices in Kosovo. We will examine the importance of implementing international financial reporting standards, but also expectations and benefits of those who are interested to use the financial data; they can be in first place the foreign investors, but also the public opinion and media that are interested in developments on economy and institutions. In this paper will be

presented used data collected from written sources but also interviews with professionals of finance branch and financial managers. In the end will be given the conclusions and recommendations about the issue analyzed.

**Key words:** Financial Management, accounting, auditing, financial reporting.

**JEL Classifiacation:** M41-Accounting, M42-Auditing

## **1. Hyrje**

Me tranzicionin ekonomik të cilin e përjetoj dhe po e përjeton shoqëria kosovare del e pashmangshme nevoja për aplikimin e një sistemi me të avancuar të menaxhimit financiar në bizneset private, ndërmarrjet publike dhe në institucionet siç janë organizatat joqeveritare, ato qeveritare dhe në vetë institucionet e pushtetit lokal dhe ati qendror.

Faktikisht nevoja për një sistem të kontabilitetit dhe mënyrës së avancuar të menaxhimit financiar lindi që në fillim të vitit 2000 duke e pas parasysh vitin 1999 si vit të cilin mund ta cilësojmë si “viti i emergjencës”, ngritja e institucioneve shtetërore dhe fillimi i vjeljes së doganave, taksave dhe tatimeve e bene aktual evidencimin dhe menaxhimin e rrjedhës së mallrave dhe shërbimeve për çka edhe u ngrit iniciativa për aplikimin e standardeve ndërkombëtare në evidentimin e transaksioneve. Në këtë proces u inkuadruan specialistë vendas dhe ekspertë të huaj të cilët së bashku e benë realitet implementimin e sistemit të raportimit financiar të bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe revizionit financiar. Fakti se në Kosovë ka në dispozicion një numër të konsiderueshëm të specialistëve financiar e beri më të lehtë që në konsultim me përvojat e vendeve të Evropës Juglindore dhe të atyre Europine të aplikohen standardet ndërkombëtare. Kjo fazë e implementimit të standardeve ndërkombëtare vazhdon edhe tani me intensitet të ashtuquajtur “hap pas hapi” në mënyrë që të i jepet kohë komunitetit të biznesit për adaptim në kushtet e reja të afarizmit ku aplikohen rregullat e raportimit dhe evidentimit të transaksioneve si në mallra dhe shërbime ashtu edhe në ata financiare.

Sistemi bankar ( ai i bankave komercial) i dha një shtytje futjes në rrjedha të evidentimit të transaksioneve si gjë normale në nevojën që për transferet e bëra të ketë evidencë. Rol të rëndësishëm dhe vendimtar në çështjen e rregullësis së regjistrimit dhe përcjelljes së rrjedhave të grumbullimit, qarkullimit dhe shpërndarjes së mjeteve financiare me të cilat menaxhohet ka informimi i çdo subjekti që bënë pjesë në këtë zinxhirë të transaksioneve. Natyrisht se bizneset kosovare që në shumicë janë ndërmarrje të mesme dhe të vogla do të hasin gjithnjë e më shume në vështirësi për financimin e biznesit të vetë pikërisht për shkakun e

=====

menaxhimit të dobët apo keqmenaxhimit të financave dhe në përgjithësi të rrjedhës së biznesit të vetë. Këtij informimi mundë ti kontribuoj secili pjesëmarrës në procesin e menaxhimit të financave qoftë ato private apo publike, pikërisht shteti dhe institucionet që merren me politikat fiskale e kanë rolin vendimtar në informimin dhe edukimin e bizneseve për obligimet e tyre që të raportojnë për rrjedhën e biznesit dhe transaksionet e tyre. Faktor tjetër që ka rol në informimin dhe edukimin e bizneseve kanë shoqatat e bizneseve ( Oda Ekonomike,AKB.. etj) që duhet njëkohësisht të ofrojnë asistencë në zgjidhjen e problemeve që lindin nga mosinformimi për rregullativen ligjore dhe obligimet ndaj autoriteteve fiskale në vend dhe jashtë tij. Faktorë tjetër që ka ndikim në informim për mënyrën dhe metodat për menaxhimin e financave janë bankat komerciale të cilat për klientët e vetë duhet të krijojnë kushte optimale në kuadër të mundësive të veta për mbajtjen dhe zgjerimin e biznesit pikërisht në asistimin e atij menaxhimi duke bërë planifikimin e rrjedhës së parasë dhe buxhetimin me kohë të investimeve të parapara. Për të arrit që niveli i menaxhimit të financave të bëhet transparente ka qenë e nevojshme të krijohet infrastruktura ligjore për kushtet dhe mënyrën e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve dhe evidencën e këtyre transaksioneve. Rregulloret e UNMIK-ut u përshtaten, si dhe u bënë ligjet të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës duke filluar nga Ligjet sistemore për doganën, taksat dhe tatimet e deri tek udhëzimet për transparencën e transaksioneve financiare brenda vendit dhe jashtë. BQK ( Banka Qendrore e Kosovës) si Institucion kryesor financiar në Kosovë në marrëdhëniet shoqërore ekonomike të tanishme ka detyrë dhe duhet të avancoj në atë drejtim që të sinjalizoj dhe të tregojë për joligjshmërit, moskuptimin dhe vështirësit në aplikimin praktik të rregulloreve të ndryshme që i përkasin qarkullimit dhe menaxhimit të rrjedhave financiare. Administrata Tatimor e Kosovës gjithashtu si agjencion në shërbim të qeveris ka obligim dhe detyrë që së pari të mbikëqyr implementimin e ligjit por edhe të ndërhyj aty ku vërehet një ngecje për shkaqe të mos zbatueshmeris së rregulloreve pikërisht me qëllim të mbrojtjes së komunitetit të bizneseve duke u mundësuar në këtë mënyrë një kohë për menaxhimin sa ma të mirë të financave të tyre pa e lenë anash përmbushjen e obligimeve ndaj taksave dhe tatimeve.

## **2. Arritjet në zhvillim dhe implementim të menaxhmentit financiar tek ndërmarrjet dhe institucionet në Kosovë**

Në menaxhimin e financave në ndërmarrjet kosovare vend të rëndësishëm duhet të kenë këto principe që kanë të bëjnë me financimin e bizneseve dhe në përgjithësi me rrjedhën, planifikimin dhe gjendjen financiare të biznesit.

Këto principe mundë të përshkruhen si:

- Principet bazë të financave,
- Principet për politiken financiare,
- Principi i planifikimit të financimit dhe rrjedhës së financave,
- Principi i analizës së financimit dhe rrjedhës së financave,
- Principi i kontrollës së arsyeshmërisë së përdorimit të mjeteve financiare..

Mundë të vendosen edhe principe tjera por këtu do të ndalemi vetëm tek këto duke i përshkruar dhe dhënë ide specialistëve që vetë të përcaktojnë nevojën për njohuri të reja në këtë lëmi dhe të avancojnë njohurit ekzistuese teorike por edhe praktike të veta.

Sa më shumë që një biznes i përmbahet principeve të financimit aq më pak do të jetë në rast të vijë në kundërshtim me rregullativen ligjore dhe vetë përshtatjes në ekonominë e tregut.

*Principet bazë të financave* – mundë të përshkruhen më sa vijon duke pas parasysh se mundë të vendoset për shumë sish varësisht nga nevojat dhe madhësia e biznesit. Principi mbi subjektin që financohet, principi mbi funksionin e njësisë monetare (euros), principi i vështirimit të biznesit nga aspekti i financave, principi i burimit të mjeteve monetare për financim, principi i ndërlidhjes së rrjedhës së financave, principi i rentabilitetit në financim, pastaj principi i sigurisë dhe likuiditetit, duhet që të ekzistoj edhe principi i stabilitetit dhe ndershmërisë në financim.

*Principet për politiken financiare*- në një biznes mundë të realizohen në kuadër të politikës afariste dhe zhvillimore të veta duke vendosë : cakun kryesor financiar, zgjidhjes dhe formulimit të strategjisë financiare, zhvillimit të një organizimi vertikal dhe horizontal financiar, si dhe mbështetja në principin e vendosjes për financimin dhe rrjedhat financiare. Në principet e politikës financiar tentohet që të arrihet një optimum në mesë të gjerësisë, nivelit dhe strukturës së përbërësve të politikës si p.sh. Optimumi në strukturën në mesë të obligimeve ndaj burimit të financave, pastaj politika e optimumit të solovences( aftësisë paguese).

Politiken financiare e formulojnë dhe e propozojnë shërbimet profesionale financiare në kuadër të biznesit si dhe trupat udhëheqës në biznes (bordet e drejtorëve etj.)

*Principi i planifikimit të financimit dhe rrjedhës së financave*- është një prej principeve që kanë të bëjnë me planifikimi në kuadër të biznesit dhe për këtë arsye bihen këto lloje të planeve: plani i mundësive investuese (aftësia e biznesit për të investuar), plani për mjetet financiare të nevojshme, plani për burimin e mjeteve për financim, plani i inkasimit dhe pagesës së mjeteve financiare, si dhe plani për plasmanin e mjeteve financiare.

*Principi i analizës së financimit dhe rrjedhës së financave*- është një prej principeve që ka të bëjë me shumti me monitorimin e devijimeve si

=====

në planin e financimit ashtu edhe në planin e rrjedhës së financave. Kjo pikësëpari ka të bëjë me analizën e :

- efikasitetit financiar të investimeve të bëra në mjetet themelore dhe në ato të lëvizshme,
- çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhënjetë afariste me “burimin e financimit”,
- çështjet që kanë të bëjnë me stabilitetin financiar, likuiditetin dhe solvencen, dhe përcjellja e plasmanëve financiare.

*Principi i kontrollit të arsyeshmërisë së përdorimit të mjeteve financiare*- është princip të cilit duhet që ti përmbahen ndërmarrjet dhe për këtë janë përgjegjës sektori financiar dhe kontrolli i brendshëm i ndërmarrjes që e analizojnë arsyeshmërinë e shfrytëzimit të mjeteve financiare , rrjedhës së mjeteve financiare dhe krahasimit të situatës aktuale me atë të planifikuar.

Duhet cekur se kontrollin e ligjshmërisë dhe mënyrës së shfrytëzimit të mjeteve financiare në ndërmarrje e bënë Administrata Tatimore por edhe auditori i jashtëm si organe eksterne.

### **3. Trashëgimia dhe ndryshimet pozitive të nevojshme në implementimin e standardeve të kontabilitetit dhe revizionit financiar**

Edhe Kosova sikurse edhe vendet e tjera të Evropës Juglindore e ka trashëguar përvojën me një sistem “gjigant” të kontabilitetit dhe të sistemit tatimor që ka qenë ngarkesë për biznesin dhe zhvillimin e ekonomisë së tregut.

Menjëherë pas luftës në vitin 1999 janë bërë përgatitjet dhe konsultimet iniciuar nga Faktori Vendor dhe Ndërkombëtar qeverisës për aplikimin e një sistemi të duhur, së pari të *sistemit tatimor* e pastaj kjo është pasuar me implementimin gradual të *standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe revizionit financiar* për të vazhduar edhe në ditët e sotme me rritjen e numrit të standardeve të aplikueshme në raportimet financiare që ndërmarrjet biznesore duhet të përgatisin dhe të raportojnë tek Administrata Tatimore e Kosovës. Natyrisht se me radhë vijnë principet të cilat duhet të ekzistojnë në lëmin e evidentimit të transaksioneve financiare gjegjësisht Kontabilitetit.

Principet në kontabilitet e kanë arsyen e ekzistimit në atë që funksioni i kontabilitetit të mos jetë vetëm i rregulluar me ligje dhe rregullore por edhe me rregullat e pranura gjerë nga profesionistët e kontabilitetit.

Principet e kontabilitetit mundë të grupohen në :

- principet fillestare të kontabilitetit,
- principi i shprehjes në kontabilitet të kategorive ekonomike,

=====

- principet e llogari mbajtjes,
- principi për planifikimin në kontabilitet,
- principi për mbikëqyrjen në kontabilitet,
- principi i organizimit të shërbimit të kontabilitetit.

Këto principe përpunohen në bazë të standardeve të kontabilitetit dhe në bazë të specifikave të vetë ndërmarrjes, madhësisë së saj, personelit profesional në dispozitim etj.

Qëllimi parësor i atyre që mbikëqyrin raportimin financiar të ndërmarrjeve por edhe i vetë biznesit është që në bazë të implementimit të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe revizionit financiar të arrihet:

- së pari drejtimi i kaheve financiare nga ekonomia joformale në atë formale,
- së dyti që të identifikohet kapaciteti i kapitalit të bizneseve veç e veç, dhe të ati kosovar në përgjithësi, dhe
- së treti të evitohet në masë sa ma të madhe manipulimi, falsifikimi dhe prodhimi i dokumentacionit të rrejshëm kontabël.

Standardet e Revizionit që shfrytëzohen në Kosovë por që janë edhe ndërkombëtar bazohen dhe duhet të bazohen në këto principe:

Revizionin Financiaro-Ekonomik mundë ta bëjnë vetëm personat e kualifikuar dhe me përvojë profesionale dhe që janë të pavarur nga ndërmarrja apo institucioni tek i cili kryhet revizioni financiaro-ekonomik, si dhe që ndaj detyrës të kenë qëndrim profesional.

Revizioni dhe punët që duhet kryer planifikohen në mënyrë profesionale, ndërsa personelin e ri dhe me praktikë të vogël vazhdimisht duhet udhëzuar dhe mbikëqyrë.

Revizioni financiaro-ekonomik duhet të bëjë hulumtimin dhe vlerësimin e punës së kontrollit të brendshëm në ndërmarrje dhe institucione, dhe varësisht nga vlerësimi përcaktohet volumi dhe mënyra, si dhe koha e nevojshme për kryerjen e kontrollit gjegjësisht revizionit.

Gjatë kontrollit duhet mbledhë sa më shumë informata, dokumente dhe dëshmi që do të shërbejnë për lëshimin e opinionit të revizorit për objektivitetin e prezantimit të gjendjes ekonomiko-financiare dhe rezultateve të afarizmit.

Në opinionin e revizorit duhet gjithsesi të ceket se a janë raportet financiare real dhe në mënyrë objektive e paraqesin situatën financiare të ndërmarrjes apo institucionit tek i cili është kryer kontrolli dhe se ato raporte janë përpiluar në harmoni me principet e kontabilitetit.

Assesi nuk duhet që revizioni financiaro-ekonomik të renditet në funksionin e kontabilitetit dhe të shikohet si pjesë e analizës kontabël dhe mbikëqyrjes kontabël . Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të

kontabilitetit dhe revizionit financiar e shtron domosdoshmërishtë nevojën për ekspertë të profesionit dhe atë në një numër të konsiderueshëm. Pikërisht kjo ndikoj dhe ndikon në orientimin e numrit gjithnjë në rritje të punëkërkesve potencial në aftësimin për kryerjen e punës lidhur me financat, kontabilitetin dhe revizionin financiar.

#### **4. Përfundime**

Në studimin e gjendjes së implementimit të kontabilitetit dhe revizionit financiar në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit që do të ketë ndikim direkt në kualitetin e menaxhimit financiar është e vërejtur:

- niveli dhe tempi jo i kënaqshëm i implementimit të rregulloreve mbi raportimin financiar,
- niveli dhe tempo jo i dëshiruar i implementimit të raportimit në bazë të standardeve ndërkombëtare,
- niveli i ulte i bashkëpunimit të autoriteteve tatimore në Kosovë me bizneset rreth përgatitjes, kontrollit dhe avancimit të raportimit financiar,
- gatishmëria e zbehte e biznesit kosovar për përshpejtimit të futjes së rrjedhës së parasë dhe mallrave në evidencën kontabël,
- ngritja e aktivitetit të shoqatës së kontabilistëve dhe revizorëve për aftësimin e kuadrit profesional nëpërmes kurseve të avancuar,
- ngritja e vetëdijes në institucionet tatimore për nevojën e edukimit të bizneseve e jo vetëm ndëshkimi.

#### **5. Rekomandime**

Në vazhdim do japim disa rekomandime për procesin në vazhdim të implementimit dhe avancimit të menaxhimit financiar, raportimit financiar dhe revizionit financiar:

- Aplikimi i metodave dhe standardeve ndërkombëtare në menaxhimin financiar, raportimin financiar dhe revizionin financiar nuk duhet të jete vetëm thjeshtë një cak, por gjithnjë duhet te shikohet si një zgjidhje optimale që do të ndihmoj biznesin në zhvillim dhe sistemin buxhetor të vendit në mbështetjen në të hyra reale.
- Menaxhimi financiar, raportimi financiar dhe revizioni financiar në biznes dhe institucione duhet të implementohen jo si një imponim por si një vlere e arritjeve më të avancuara në botën e biznesit global.,

- Aplikimi i menaxhmentit financiar, raportimit financiar dhe revizionit financiar në biznese dhe institucione duhet të kryhet jo në baze të interesave politike dhe grupacioneve të ndryshme por si interes i vendit për të përfituar investitorët e jashtëm dhe kapitalin e huaj si vend i sigurt dhe me rregulla e ligje që dihen paraprakisht.
- Menaxhimi financiar, raportimi financiar dhe revizioni financiar në biznese dhe institucione duhet larguar nga ndikimi i përfitimeve afatshkurtra dhe ndryshimi i shpeshtë i udhëzimeve, rregullave dhe standardeve.
- Në menaxhimin financiar, raportimin financiar dhe revizionin financiar duhet të behet përfitimi i mundshëm nga konsulenca e organizatave ndërkombëtare, ekspertiza e huaj në drejtim të ngritjes së kuadrit profesional dhe implementimit pragmatik të asaj që është e mundshme të implementohet.
- Koordinimi i veprimeve dhe masave në mese të biznesit, shoqatës së kontabilistëve, administratës tatimore dhe subjekteve tjera të përfshira në liberalizimin e politikës fiskale që do të ndikonte në stabilizimin makroekonomik, liberalizimin dhe reformat në sistemin tatimor.
- Të shihet mundësia që të institucionalizohet dhe standardizohet puna e kontabilistëve të certifikuar dhe revizorëve të certifikuar si një mundësi për punësim dhe mundësi të avancimit profesional.
- Të bëhet informimi publik intensiv dhe me kohë për rrjedhat dhe risit në lëmin e menaxhmentit financiar, raportimit financiar dhe revizionit financiar.
- Eliminimi i paragjytimeve të bizneseve për evazion fiskal dhe drejtimin e ekonomisë gri kah ajo formale.
- Eliminimin e korrupsionit me anë të një kontrole permanente dhe të drejte të raportimit financiar nga ana e revizorëve ekstern por edhe ngritja e kontrollës interne si preventiv.

Objektiva e atyre që e kanë për detyrë dhe obligim të kujdesen për aplikimin e standardeve menaxhimin financiar, në kontabilitet dhe revizion duhet të jenë të lidhura ngushtë me interesat e atyre që përgatisin kuadro profesioniste por edhe me komunitetin e biznesit, pra që qëllimi i veçantë i secilit akterë të jetë në lidhje të ngushtë dhe i harmonizuar me qëllimin e përbashkët .

Shkalla e efikasitetit në implementimin e standardeve varet nga koordinimi i aktiviteteve në mesë të akterve në nivel të vendit, gjegjësisht të Institucioneve, Shoqatave dhe vetë Bizneseve.

Aktivitetet e secilit lidhen me forcën e zbatimit të strategjisë së tyre dhe synimet e tyre duhet të jenë të lidhura për të rritë punësimin, me këtë rast paralel me avancim në integrimin në rrjedhat globale të tregut.

### **Referencat:**

1. Epstein Barry, Jermakowicz Eva, 2007, "IFRS 2007, Interpretation and application of International financial Reporting standards", John Wiley & Sons, Inc.
2. Auditimi i avancuar, SHKCAK, Prishtine,
3. R.Meigs, J.Williams, S.Haka, M.Bettner "Financial Accounting", Irwin McGraw Hill, New York, 2001,
4. Charles W.L.Hill "International Business", McGraw Hill Higher Education, New York, 2001,
5. E.John Larsen "Modern Advanced Accounting", McGraw Hill, New York, 2000,
6. Raportet e MEF, 2004-2010,  
<http://mef-rks.org/sq/download/323-raporte-dhe-publikime-tjera>  
<http://mef-rks.org/sq/sekretariati-i-bordit-kosovar-mbi-standardet-dhe-raportimi-financiar->
7. Ligjet dhe Rregulloret mbi tatimin dhe taksat e aplikueshme në Kosovë.  
<http://www.atk-ks.org/legjislacioni/ligjet/>
8. Ligji Nr. 03/L-222-për Administratën tatimore dhe Procedurat.
9. Shoqata E Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (*Shkçak*)  
[www.scaak-ks.org/](http://www.scaak-ks.org/)

=====